

**OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT  
DEPARTAMENTI I RRJETIT TË TRANSMETIMIT  
DREJTORIA E PROJEKTEVE TË HUAJA  
DREJTORIA EKONOMIKE**

Nr. 3241 prot.

Tiranë, më 13.05.2019

Lënda: Mbi miratimin e Planit të Investimeve për vitin 2019 të OST.

**Z. Petrit Ahmeti  
Kryetar i Entit Rregullator të Energjisë**

I nderuar Z. Ahmeti,

Në mbështetje të Vendimit Nr. 54, datë 03.04.2019, “Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e Planit të Investimeve për vitin 2019 për shoqërinë OST Sh.a.” po ju dërgojmë Planin e Investimeve për Vitin 2019 së bashku me relacionet përkatëse.

**A. Tabela e Planit të Investimeve me Fondet e Veta të vitit 2019**

Nr.	Investime 2019	Vlera totale e investimit	Vlera e realizuar gjatë vitit 2018	Vlera për t'u realizuar gjatë vitit 2019
<b>Zëra të parashikuar në planin e investimeve të vitit 2018 që shtrihen në vitin 2019</b>				
1	Linja e re 220 kV Burrel – Peshkopi plus 1(nje) trakt 220 kV Lot 1	1,300,000,000	-	260,000,000
2	Furnizim vendosje e Shunt reaktorit 400kV 120 MVAR, Sistemit Total te monitorimit te tij, Konfigurimin ne sistemin SCADA, furnizimin dhe vendosjen e Traktit 400 kV ne N/st Zemblak si dhe kryerja e te gjitha punimeve civile ne lidhje me kete projekt.	543,142,511	502,518,427	40,624,084
3	Rikonstruksioni i linjave 110 kV Laç2-Ura e Matit dhe Skuraj Ura e Matit	194,391,996	-	97,195,998
4	Rehabilitimi i trakteve te linjave 110 kV te nenstacionit Jagodine	187,048,800	37,409,760	149,639,040
5	Ndertimi i linjes 110 kV N/st Sallmone – Gjiri i Lalezit	182,877,079	36,575,416	133,575,302
6	Rehabilitimi i trakteve te linjave 110 kV te nenstacionit F.Arrez	156,942,900	31,388,580	113,312,490
7	Rehabilitimi i trakteve te linjave 110 kV te nenstacionit Ibe	97,210,290	19,442,058	77,768,232
8	Rehabilitimi i trakteve te linjave 110 kV te nenstacionit Plasmas	95,161,092	19,032,218	76,128,874
9	Rehabilitimi i trakteve te linjave 110 kV te nenstacionit Kajjan	105,633,163	21,126,633	84,506,530
10	Rehabilitimi i trakteve te linjave 110 kV te nenstacionit Prenjas	106,934,131	21,386,826	76,646,281
11	Rikonstruksioni i anes 110 kV te nenstacionit Rubik	125,308,324	77,511,061	47,631,371
12	Rehabilitimi i trakteve te linjave 110 kV te nenstacionit Librazhd	99,946,077	19,989,214	79,956,863
13	Aksesi dhe monitorimi i rrjetit te transmetimit te sistemeve te komunikimit me kapacitete	64,119,000	51,295,000	12,824,000
14	Instalimi i OPGW ne linjen 220 kV Burrel – Elbasan 1	60,491,245	12,098,249	48,392,996
15	Implementimi i Sistemit te Analizimit te Rrjetit nepernjete PMU (Phasor Measuring Unit)	39,514,000	27,468,000	12,046,000
16	Ndertimi i Magazines prane N/stacionit Tirana2	36,503,650	7,300,730	29,202,920
17	Furnizim vendosje e traktit te linjes 110-13 ne N/stacionin Laç1 dhe punime civile	31,704,481	6,340,896	25,363,585
18	Plotesimi dhe venia ne pune e Traktit 110 kV ne nestacion Fier per N/stacionin 110/20 kV te OSHEE + trainimi i personelit Inxhiniero –teknik te DSHMT	40,952,000	8,190,400	32,761,600
19	Sistemimi i problematikave te drenazhimit ne Nenstacionit Tirana2	14,669,675	2,933,935	11,735,740
20	Nderrhyrje ne linjat e transmetimit 110/220 kV te rajonit te Njesise Operative Shkoder	19,205,818	3,841,164	15,364,654
21	Mbikqyrja e punimeve per objektet e reja.	34,637,000	12,536,763	22,100,237
22	Ngritja e nje sistemi per lokalizimin e avarive ne linjat e trasmetimit. Blerje, instalim, konfigurim i serverit per analizatoret e vajit te AT -ve dhe celsave te nivelit 110kV e lart.	158,000,000	52,720,000	105,280,000
23	Furnizim i nje celsi te ri 245 kV me gas SF6 si dhe pjese reserve te tij dhe per celsat aktual, 3(tre) analizatore per celsat e niveleve te ndryshme tensioni si dhe 2(dy) paisje mbrojtjeje, automatizimi dhe monitorimi.	49,086,000	23,122,000	25,964,000
24	Lyerja e shtyllave të transmetimit të TL	74,722,297	-	74,722,297
25	Integrimi i N.st. Elbasan 1 dhe Elbasan 2 në sistemin e monitorimit dhe programimit online të Sistemit të Mbrojtjes RELE	19,145,000	-	19,145,000
<b>Total i</b>		<b>3,837,346,529</b>	<b>994,227,330</b>	<b>1,671,888,093</b>

Nr.	Investime 2019	Vlera totale e investimit	Vlera e realizuar gjatë vitit 2018	Vlera për t'u realizuar gjatë vitit 2019
<b>Zëra të parashikuar në planin e investimeve të vitit 2019</b>				
26	Ndërtim i N/st 220/110 kV, 1x120 MVA Shumat (Peshkopi)	700,000,000	-	140,000,000
27	Linja 110kv N/St Fiber -Librazhd	450,000,000	-	70,000,000
28	Punime per perfundimin e linjes kabllore 110 kV Tirana-Selite dhe lidhja me nenstacionin 110/20 kV Kombin	100,000,000	-	83,000,000
29	Furnizim dhe vensosje e celave rezerve 20 kV dhe 35 kV per N/st Tirana1 dhe pjese kembimi per keto celsa	45,000,000	-	45,000,000
30	Nderhyrje per rastet emergjence ne linjat e TL	40,000,000	-	40,000,000
31	Blerje Paneleve te mbrojtjes dhe komandimit per trakte 110 kV	50,000,000	-	50,000,000
32	Blerje materiale per nenstacione	100,000,000	-	100,000,000
33	Blerje materialesh dhe vegla punet e sigurimit teknik si dhe pajisjet per testimin e mjeteve te sigurimit teknik	30,000,000	-	30,000,000
34	Upgrade i sistemit te kontrollit dhe BCU te N/st 220 kV Koplik	36,000,000	-	36,000,000
35	Upgrade Hardware-Software i sistemit te kontrollit te nenstacionit 400/220/110kV Tirana 2	38,000,000	-	38,000,000
36	Blerje programi kompjuterik per analizen e rjetit	12,000,000	-	12,000,000
37	Blerjen e dy licensave USB per program kompjuterik PSS©E per analizen e rjetit	12,000,000	-	12,000,000
38	Mbikqyrje e punimeve gjate zbatimit te kontratave	13,000,000	-	13,000,000
<b>Total 2</b>		<b>1,626,000,000</b>	<b>-</b>	<b>669,000,000</b>
<b>TOTALI I INVESTIMEVE</b>		<b>5,463,346,529</b>	<b>994,227,330</b>	<b>2,340,888,093</b>

Më poshtë gjeni relacionet përkatëse për secilin nga zërat në listën e Planit të Investimeve me Fondet e Veta të vitit 2019:

### 1. Linja e re 220 kV Burrel – Peshkopi dhe N/Stacioni 220/110 kV Shumat (Peshkopi)

Rrjeti unazor 110 kV ndërmjet nënstacioneve 220/110 kV Fierzë dhe 220/110 kV Burrel që shtrihet në zonën verilindore ka një gjatësi të përgjithshme prej rreth 150 km, i ndërtuar kryesisht gjatë viteve 1967-1969, me pjesën më të madhe të segmenteve me përcjellës AC 95 mm<sup>2</sup>. Në këtë rrjet janë lidhur nënstacionet 110 kV F.Arrëz, Kalimash, Tunel, Kukës, Peshkopi, Vojnik, Shupenzë, Bulqizë dhe Suc si dhe HEC-et Dardhë, Truen, Bele, Lapaj, Gjoricë, Ternove, Klos.

Në periudhat me shumë rreshje, kur dhe gjenerimi i centraleve të kësaj zone është maksimal, shfaqen mbingarkime të palejuara të linjave 110 kV që e bëjnë të domosdoshme kufizimin e gjenerimit. Duke patur parasysh dhe kushtet e vështira të motit dhe terrenit ku ato kalojnë, ndërprerjet janë të shpeshta dhe koha e riparimit të tyre relativisht e gjatë.

Në situata të tilla, për shkak të gjatësisë së madhe të rrjetit unazor, edhe profili i tensionit pëson një thyerje të theksuar duke arritur në burimet gjeneruese të largëta në vlera që arrijnë kufijtë maksimal të lejuar. Nga ana tjetër dhe humbjet e energjisë elektrike rriten së tepërmi. Sipas llogaritjeve të bëra për vitin 2020, që merr në konsideratë dhe vënien në operim të centraleve të rinj që tashmë janë në fazë përfundimi, në kushtet e gjenerimit me 90 % të kapacitetit të instaluar të centraleve të zonës, për të shmangur mbingarkimet e rrjetit është e domosdoshme të kufizohet një gjenerim prej rreth 50 MW, në kushtet kur nuk ka asnjë defekt dhe i gjithë rrjeti është në operim.


Në këto kushte, rikonstruksioni dhe fuqizimi i këtij rrjeti përbën një emergjencë.

Zgjidhja më optimale, që do të krijonte mundësinë edhe të fuqizimit të mëtejshëm të unazës në trasetë ekzistuese të linjave 110 kV, është ndërtimi i linjës së re 220 kV Burrel – Peshkopi dhe N/Stacioni 220/110 Shumat (Peshkopi). Ky projekt parashikon ndërtimin e një linje të re 220 kV Burrel – Peshkopi rreth 46 km, instalimin e një trakti 220 kV pranë N/Stacionit 220/110/10 kV Burrel dhe ndërtimin e N/Stacionit të ri 220/110 (Shumat) Peshkopi me fuqi të instaluar 120 MVA. Vlera e projektit është rreth 2 miliard Lekë e shtrirë në tre vite.

Projekti do të garantojë operimin optimal të burimeve hidrike të zonës duke shmangur reduktimin e gjenerimit në periudhën me shumë ujë. Ai do të mundësojë lidhjen në rrjet dhe absorbimin e gjenerimit të burimeve të reja dhe do të garantojë një furnizim cilësor për konsumatorët. Ai ka një impakt të madh në reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike dhe përmirësimin e profilit të tensionit.

Në figurën e mëposhtme jepet diagrama njëfazore e rrjetit unazor 110 kV të zonës Verilindore:

### Burimet e reja gjeneruese në Rajonin Verilindor



## **2. Furnizim-vendosje e shunt-reaktorit 400 kV (120 MVA) dhe traktit 400 kV në N/Stacionin Zemblak**

Ky projekt parashikon furnizim-vendosjen e shunt-reaktorit në nivel 400 kV me kapacitet 120 MVA, sistemit total të monitorimit të tij, konfigurimin e sistemit SCADA, furnizim-vendosjen e traktit 400 kV në N/Stacionin Zemblak si dhe kryerja e të gjitha punimeve civile në lidhje me këtë projekt me ane të të cilit synohet rregullimi i nivelit të tensionit. Projekti është në fazën e implementimit dhe parashikohet të komisionohet përgjatë vitit 2019.

Impakti i këtij projekti është në rregullimin e nivelit të tensionit në rrjetin 400 kV në një nyje të rëndësishme të interkonjeksionit, duke marrë në konsideratë se kemi të bëjmë me një problematikë rajonale (nivel i lartë i tensionit në rajonin e Ballkanit në rrjetin e transmetimit).

## **3. Rikonstruksioni i linjave 110 kV Laç2-Ura e Matit dhe Skuraj –Ura e Matit**

Ky projekt parashikon demontimin e linjës ekzistuese 110 kV Laç 2 – Ura e Matit dhe Skuraj – Ura e Matit dhe ndërtimin e linjës të re 110 kV (me dy qarqe me përcjellës ACSR 240/40 mm<sup>2</sup> Laç 2 – Ura e Matit dhe me një qark me përcjellës ACSR 240/40 mm<sup>2</sup> Skuraj – Ura e Matit).

Kontrata është nënshkruar në Mars të vitit 2019 dhe pritet gjatë këtij viti të fillojë puna për ndërtimin e tyre.

Projekti rrit sigurinë e furnizimit me energji elektrike në një zonë me konsumatorë familjare dhe krijon mundësi për rritjen e zhvillimit ekonomik të industrive të pranishme në këto zona nëpërmjet rritjes së cilësisë së furnizimit me energji elektrike.

## **4. Rehabilitimi i impiantit 110 kV të N/Stacionit 110/35/6 kV Jagodinë**

Projekti parashikon demontimin dhe rikonstruksionin e impiantit 110 kV të N/Stacionit Marinëz (Jagodinë), nëpërmjet rikonstruksionit të zbarrave 110 kV, seksionuesi të zbarrave, dy traktet 110 kV ekzistues të linjave dhe dy traktet 110 kV të reja (përkatesisht linjës 110 kV Marinëz – Fier, linjës 110 kV Marinëz – Kuçovë, linjës 110 kV Marinëz – Fier dhe linjës 110 kV Marinëz – Ballsh), përmes rehabilitimit të anës primare dhe sekondare të tyre.

Është miratuar projekti i zbatimit dhe po vazhdohet me procedurat për dorëzimin e sheshit të ndërtimit. Brenda vitit 2019 pritet të përfundojë dhe të komisionohet objekti.

Projekti rrit sigurinë e furnizimit me energji elektrike në një zonë me konsumatorë familjar dhe krijon mundësi për rritjen e zhvillimit ekonomik të industrive të pranishme në këto zona nëpërmjet rritjes së cilësisë së furnizimit me energji elektrike.

## **5. Ndërtimi i linjës 110 kV N/Stacioni Sallmone – Gjiri i Lalëzit**

Ky projekt parashikon ndërtimin e një trakti linje 110 kV në N/Stacionin Sukth (Sallmone) për linjën Sallmone – Gjiri i Lalëzit, ku përfshihen punimet civile, suportet metalike dhe

instalimin e pajisjeve primare dhe sekondare. Gjithashtu projekti përfshin ndërtimin e një linje të re 110 kV me një qark me përcjellës ACSR 240/40 mm<sup>2</sup>, rreth 17,5 km të gjatë.

Është miratuar projekti i zbatimit dhe kanë filluar procedurat për marrjen e lejeve mjedisore dhe shpronësimeve. Në fillim të vitit 2020 parashikohet të komisionohet objekti.

Projekti rrit sigurinë dhe cilësinë e furnizimit me energji elektrike në një zonë me mundësi për zhvillimin e mëtejshëm të turizmit.

#### **6. Rehabilitimi i N/Stacionit 110/35/10kV Fushë Arrëz (impianti 110kV i nënstacionit)**

Projekti përfshin demontimin dhe rikonstruksionin e impiantit 110kV të N/Stacionit Fushë Arrëz, nëpërmjet rikonstruksionit të zbarrave 110 kV dhe tre traktet 110 kV të linjave (përkatesisht linjës 110 kV F.Arrëz – Fierze, linjës 110 kV F.Arrëz – Repe dhe linjës 110 kV F.Arrëz – Kalimash), përmes rehabilitimit të anës primare dhe sekondare të tyre.

Është miratuar projekti i zbatimit dhe po vazhdohet me procedurat për dorëzimin e sheshit të ndërtimit. Objekti parashikohet të komisionohet në fillim të vitit 2020.

Projekti rrit sigurinë dhe cilësinë e furnizimit me energji elektrike në një zonë me konsumatorë familjar dhe HEC-e të lidhur në rrjetin e shpërndarjes.

#### **7. Rehabilitimi i N/Stacionit 110/10kV Ibë (impianti 110kV i nënstacionit)**

Ky projekt përfshin demontimin dhe rikonstruksionin e impiantit 110 kV të N/Stacionit Ibë, nëpërmjet rikonstruksionit të zbarrave 110 kV dhe dy traktet 110 kV të linjave (përkatesisht linjës 110 kV Ibë – Elbasan 1 dhe linjës 110 kV Ibë – Farkë), përmes rehabilitimit të anës primare dhe sekondare të tyre.

Është miratuar projekti i zbatimit dhe po vazhdohet me procedurat për dorëzimin e sheshit të ndërtimit. Objekti parashikohet të komisionohet brenda vitit 2019.

Projekti rrit sigurinë dhe cilësinë e furnizimit me energji elektrike në një zonë me konsumatorë familjar.

#### **8. Rikonstruksioni i N/Stacionit 110/35/20/6kV Lushnjë (Plasmas) (impianti 110 kV i nënstacionit)**

Projekti përfshin demontimin dhe rikonstruksionin e impiantit 110 kV të N/Stacionit Lushnjë (Plasmas), nëpërmjet rikonstruksionit të zbarrave 110 kV dhe dy traktet 110 kV të linjave (përkatesisht linjës 110 kV Lushnjë – Fier dhe linjës 110 kV Lushnjë – Kavajë), përmes rehabilitimit të anës primare dhe sekondare të tyre.

Për vitin 2019, është dorëzuar sheshi i ndërtimit dhe pritet fillimi i punimeve. Brenda vitit 2019 pritet të përfundojë dhe të komisionohet objekti.

Projekti rrit sigurinë e furnizimit me energji elektrike në një zonë me konsumatorë familjar dhe krijon mundësi për rritjen e zhvillimit ekonomik të industrive të pranishme në zonë nëpërmjet rritjes së cilësisë së furnizimit me energji elektrike.

#### **9. Rikonstruksion i N/Stacionit 110/10kV Kajan (impianti 110kV i nënstacionit)**

Ky projekt përfshin demontimin dhe rikonstruksionin e impiantit 110 kV të N/Stacionit Kajan, nëpërmjet rikonstruksionit të zbarrave 110 kV dhe dy traktet 110 kV të linjave (përkatesisht linjës 110 kV Kajan – Kuçovë dhe linjës 110 kV Kajan – Cërrik), përmes rehabilitimit të anës primare dhe sekondare të tyre.

Përgjatë vitit 2019 është dorëzuar sheshi i ndërtimit dhe pritet fillimi i punimeve për këtë objekt. Objekti parashikohet të komisionohet brenda vitit 2019.

Projekti rrit sigurinë dhe cilësinë e furnizimit me energji elektrike në një zonë me konsumatorë familjar.

#### **10. Rehabilitimi i N/Stacionit 110/35/6kV Prrenjas (impianti 110kV i nënstacionit)**

Ky projekt parashikon demontimin dhe rikonstruksionin e impiantit 110 kV të N/Stacionit Prrenjas, nëpërmjet rikonstruksionit të zbarrave 110 kV dhe dy traktet 110 kV të linjave (përkatesisht linjës 110 kV Prrenjas – Librazhd dhe linjës 110 kV Prrenjas – Gur i Kuq), përmes rehabilitimit të anës primare dhe sekondare të tyre.

Është miratuar projekti i zbatimit dhe po vazhdohet me procedurat për dorëzimin e sheshit të ndërtimit. Objekti parashikohet të komisionohet në fillim të vitit 2020.

Projekti rrit sigurinë dhe cilësinë e furnizimit me energji elektrike në një zonë me konsumatorë familjar.

#### **11. Rehabilitimi i N/Stacionit 110/35/6kV Rubik (impianti 110kV i nënstacionit)**

Ky projekt përfshin demontimin dhe rikonstruksionin e impiantit 110 kV të N/Stacionit Rubik, nëpërmjet rikonstruksionit të zbarrave 110 kV dhe dy traktet 110 kV të linjave (përkatesisht traktet e linjave Rubik-Reps dhe Rubik-Skuraj), përmes rehabilitimit të anës primare dhe sekondare të tyre.

Përgjatë vitit 2019, është realizuar ndërtimi i një trakti 110 kV të linjës dhe ka filluar puna për traktin e dytë. Objekti parashikohet të komisionohet brenda vitit 2019.

Projekti rrit sigurinë dhe cilësinë e furnizimit me energji elektrike në një zonë me konsumatorë familjar.

## **12. Rikonstrukcioni i N/Stacionit 110/20/10kV Librazhd (impianti 110 kV i nënstacionit)**

Ky projekt përfshin demontimin dhe rikonstrukcionin e impiantit 110 kV të N/Stacionit Librazhd, nëpërmjet rikonstrukcionit të zbarrave 110 kV dhe dy traktet 110 kV të linjave (përkatësisht linjës 110 kV Librazhd – Rapun 3&4 dhe linjës 110 kV Librazhd – Prrrenjas), përmes rehabilitimit të anës primare dhe sekondare të tyre.

Është miratuar projekti i zbatimit dhe po vazhdohet me procedurat për dorëzimin e sheshit të ndërtimit. Objekti parashikohet të komisionohet brenda vitit 2019.

Projekti rrit sigurinë dhe cilësinë e furnizimit me energji elektrike në një zonë me konsumatorë familjar dhe HEC-e të lidhur në rrjetin e shpërndarjes.

## **13. Aksesit dhe monitorimi i rrjetit të transmetimit të sistemeve të komunikimit me kapacitete të larta.**

Ky projekt përfshin instalimin e terminaleve të aksesit në të gjithë nënstacionet e OST që kanë infrastrukturë transmetimi komunikimesh dhe module monitorimi në nyjet e komunikimit. Këtu janë përfshirë integrimi dhe menaxhimi nga qendra e menaxhimit në OST.

Projekti është në fazën e implementimit dhe parashikohet të komisionohet përgjatë vitit 2019.

Ai rrit sigurinë dhe menaxhimin e infrastrukturës së monitorimit dhe kontrollit të sistemit të transmetimit me anë të rrjetit të telekomunikacionit (OPGW – tros me fibrat optike).

## **14. Instalimi i OPGW në linjën 220kV Burrel – Elbasan1**

Projekti parashikon shtrimin e fibrës optike (OPGW) në linjën 220 kV Elbasan1 – Burrel, me një gjatësi prej 63 km, demontimin e njërit prej troseve ekzistues, vendosjen e ‘joint-box’-eve dhe krijimin e link-ut të transmetimit nga Burreli në Elbasan.

Projekti është në fazën e implementimit dhe parashikohet të komisionohet përgjatë vitit 2019.

Ai siguron rritjen e kapaciteteve transmetuese me anë të fibrës optike duke siguruar një brez më të gjërë transmetues të të dhënave dhe rritjen e shpejtësisë së komunikimit midis nënstacioneve përkatës dhe sistemit të telekomunikacionit në tërësi.

## **15. Implementimi i Sistemit të Analizimit të Rrjetit nëpërmjet PMU (Phasor Measuring Unit)**

Ky projekt përfshin implementimin e sistemit PMU me qëllim krijimin e një rrjeti i cili mundëson marrjen e të dhënave nga nënstacionet që ndërlidhen me linja interkoneksioni për



qëllime monitorimi të vazhdueshëm të situatës elektro-energjetike në sistemin e transmetimit në mënyrë dinamike.

Projekti është në fazën e implementimit dhe parashikohet të komisionohet përgjatë vitit 2019.

#### **16. Ndërtimi i Magazinës pranë N/Stacionit Tirana2**

Projekti parashikon ndërtimin e një magazine pranë N/Stacionit Tirana 2.

Përgjatë vitit 2019 është miratuar projekti i zbatimit dhe po vazhdohet me procedurat për marrjen e lejeve përkatëse. Objekti parashikohet të komisionohet brenda vitit 2019.

#### **17. Furnizim-vendosje e traktit të linjës 110-13 në N/Stacionin Laç1 dhe punime civile**

Ky projekt parashikon ndërtimin e një trakti linje 110 kV në N/Stacionin Laç1 për linjën Laç1 – Fushë Krujë - Mamurras, ku përfshihen punimet civile, suportet metalike dhe instalimin e pajisjeve primare dhe sekondare.

Projekti është në fazë implementimi, janë montuar pajisjet primare dhe janë realizuar kabllimet për anën sekondare. Janë realizuar punimet në pjesën më të madhe të kontratës. Objekti parashikohet të komisionohet përgjatë vitit 2019.

Ai rrit sigurinë e furnizimit me energji elektrike nëpërmjet krijimit të një skeme më fleksibël operimi të nënstacionit dhe zonës në tërësi.

#### **18. Plotësimi dhe vënia në punë e traktit 110kV në Fier për N/Stacionin 110/20 kV të OSHEE + trainimi i personelit inxhiniero –teknik të DSHMT**

Projekti parashikon plotësimin dhe vënien në punë të traktit 110 kV në N/Stacionin 220/110/35 kV Fier, dhe është një investim që do të ndajë nënstacionin 110 kV të OSHEE duke e furnizuar nëpërmjet një trakti të rregullt linje. Gjithashtu projekti përfshin trajnimin e personelit inxhiniero-teknik të DSHMT-së.

Projekti është në fazë implementimi dhe parashikohet të komisionohet përgjatë vitit 2019.

#### **19. Sistemimi i problematikave të drenazhimit në N/Stacionin Tirana 2**

Projekti parashikon ndërhyrje në N/Stacionit Tirana 2 për rregullimin dhe drenazhimin e ujrave të përmytjeve për të shmangur përmytjen e nënstacionit gjatë periudhave me reshje të dendura shiu.

Përgjatë vitit 2019 është miratuar projekti i zbatimit dhe po vazhdohet me procedurat për marrjen e lejeve përkatëse. Objekti parashikohet të komisionohet përgjatë vitit 2019.

Projekti synon shmangien e përmytjes duke rritur në këtë mënyrë sigurinë e operimit të nënstacionit si një objekt i rëndësishëm i sistemit.

## **20. Ndërhyrje në linjat e transmetimit 110/220 kV të rajonit të Njësisë Operative Shkodër**

Ky projekt parashikon ndërtimin e dy shtyllave të reja në linjën 220kV Koman - Vau Dejës (Berishë), në një kampion prej 1280 m, për të evituar këputjen e përcjellësve sikundër ka ndodhur gjatë dimrit. Gjithashtu projekti përfshin vendosjen e një shtylle të re për linjë 110 kV pranë degëzimit Bushtat (Shkodër).

Për vitin 2019, pritet të realizohet dorëzimi i sheshit të ndërtimit për të filluar puna me ndërtimin e shtyllave. Objekti parashikohet të komisionohet brenda vitit 2019.

Projekti rrit sigurinë e furnizimit me energji elektrike dhe shmang problematikat e evidentuara gjatë fazës së operimit.

## **21. Mbikqyrja e punimeve për objektet e reja**

Për projektet që OST zhvillon duhet të kontraktojë një shoqëri për kryerjen e supervizionit të punimeve në terren, bazuar në Ligjin Nr. 9643 date 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, VKM Nr.914 datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, Udhezimeve të Agjensisë së prokurimeve publike dhe në ligjin Nr.7850 datë 29.07.1994 "Kodi civil në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

## **22. Ngritja e një sistemi për lokalizimin e avarive në linjat e transmetimit. Blerje, instalim, konfigurim i serverit për analizatorët e vajit të AT-ve dhe çelsave të nivelit 110 kV e lart.**

Ky projekt parashikon instalimin e sistemit të lokalizimit të avarive në linjat e transmetimit dhe përfshin blerjen, instalim dhe konfigurimin e serverit për analizatorët e vajit të AT-ve Komsit (Burrel) dhe analizatorët e çelsave të nivelit 110 kV e lart.

Projekti është në fazë implementimi dhe parashikohet të komisionohet përgjatë vitit 2019.

## **23. Furnizim i një çelsi të ri 245 kV me gas SF6 si dhe pjesë rezervë të tij dhe për çelsat aktual, 3 (tre) analizatorë për çelsat e niveleve të ndryshme tensioni si dhe 2 (dy) paisje mbrojtjeje, automatizimi dhe monitorimi.**

Ky projekt parashikon furnizimin e një çelsi të ri 245 kV me gas SF6 si dhe pjesë rezervë të tij dhe për çelsat aktual, 3 (tre) analizatorë për çelsat e niveleve të ndryshme tensioni si dhe 2 (dy) paisje mbrojtjeje, automatizimi dhe monitorimi.

Projekti është në fazë implementimi dhe parashikohet të komisionohet përgjatë vitit 2019.

#### **24. Lyerja e shtyllave të transmetimit të TL**

Për mirëmbajtjen e linjave të transmetimit, të cilat në shumë raste janë të vjetra dhe me probleme të korodimit të strukturave metalike, për rritjen e jetëgjatesisë së tyre dhe qëndrueshmërisë ndaj korrozionit është e nevojshme që të trajtohen me lyerje sa herë që është e nevojshme. Në fokus do të jetë lyerja e shtyllave të një pjese të linjave 220 kV dhe në menyrë të veçantë në rajonin e veriut.

Objekti parashikohet të komisionohet përgjatë vitit 2019.

#### **25. Integrimi i N.st. Elbasan 1 dhe Elbasan 2 në sistemin e monitorimit dhe programimit online të Sistemit të Mbrojtjes RELE**

Ky projekt parashikon integrimin e N/Stacioneve Elbasan 1 dhe Elbasan 2 në sistemin e monitorimit dhe programimit online të Sistemit të Mbrojtjes Rele. Përfitimi i këtij investimi është rritja e sigurisë së operimit të sistemit elektroenergjetik.

Objekti parashikohet të komisionohet përgjatë vitit 2019.

#### **26. Ndërtimi i N/Stacionit 220/110 kV (120 MVA) Shumat (Peshkopi).**

Rrjeti elektrik në segmentet Fierze – Fushë Arrëz – Kukës – Lapaj – Peshkopi – Bulqizë – Burrel përfaqëson një unazë 110 kV me një shtrirje në të gjithë zonen verilindore të vendit, në të cilin janë në operim dhe janë në proces ndërtimi një numër i madh HEC-e me fuqi të përgjithshme 281 MW. Ky rrjet është në pamundësi të plotë për të përcjellë një kapacitet të tillë gjenerues dhe aktualisht shkakton shumë ndërprerje tek HEC-et ekzistues dhe konsumatorët e zonës.

Me përjashtim të segmentit Lapaj – Peshkopi, i ndërtuar vitet e fundit me përcjellës 240/40 mm<sup>2</sup>, të gjithë linjat e kësaj unaze janë të amortizuara dhe me seksion të përcjellësve AC-120 mm<sup>2</sup> dhe AC-95 mm<sup>2</sup>. Duke patur parasysh dhe kushtet e vështira të motit dhe terrenit ku ato kalojnë, ndërprerjet janë të shpeshta dhe koha e riparimit të tyre relativisht e gjatë.

Në periudhat me shumë uje kur kemi dhe gjenerim maksimal të centraleve të lidhur në këtë unazë, flukset e fuqisë rrjedhin nga rrjeti 110 kV në atë 220 kV nëpërmjet dy nënstacioneve 220/110 kV Burrel dhe Fierze. Në këto kushte, rikonstruksioni dhe fuqizimi i këtij rrjeti përbën një emergjencë.

Ndërtimi i nënstacionit 220/110 kV në Shumat (Peshkopi), është pjesë e projektit të fuqizimit të zonës Verilindore e cila ka si hap të parë ndërtimin e linjës 220 kV Burrel – Peshkopi, që është përfshirë në investimet e OST për vitin 2018. Pikërisht ndërtimi i linjës nuk mund të kuptohet pa ndërtimin e nënstacionit transformues 220/110 kV, që do të bëjë të mundur ndërhyrjen në mes të rrjetit unazor të zonës Verilindore.


Ky projekt është hapi i parë dhe kryesor për përmirësimin e kushteve të operimit të burimeve të shumta të hidrike në zonë dhe që krijon mundësi praktike për ndërhyrjet e kërkuara për fuqizimin e pjesëve të tjera të kësaj unaze.



Ndërtimi i këtij nënstacioni parashikon:

- Nje trakt 220 kV per linjen hyrese nga Burreli ne Peshkopi.
- Nje trakt 220 kV per transformatorin 220/110 kV.
- Nje trakt 110 kV per transformatorin 220/110 kV.
- Një transformim 220/110 kV, me fuqi të instaluar 120 MVA,
- Dy dalje linje 110 kV për të realizuar hyrje-dalje në linjën ekzistuese Lapaj- Peshkopi.
- Ndërtim të zbarave një-fishe dhe Punime civile që krijojnë mundësinë në të ardhmen për ndërtimin e zbarave dyfishe në anën 220 kV dhe 110 kV.

Projekti do të garantojë operimin optimal të burimeve hidrike të zonës dhe një furnizim cilësor për konsumatorët. Ai ka një impakt të madh në reduktimin e kufizimit të gjenerimeve të zonës ne periudhën me shumë ujë, mundësinë e lidhjes në rrjet të burimeve të reja që tashmë janë ne fazë ndërtimim, reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin 110 kV dhe përmirësimin e profilit të tensionit.

Paraqitja skematike, planvendosja dhe prerja tërthore e nënstacionit jepet në figurat më poshtë.





### 27. Ndërtimi i linjës së re me dy qarqe Fibër-Librazhd, 23 km

Rajoni Juglindor është i pasur përsa i përket hidrologjisë, është një zonë e ngarkuar me burime të reja gjeneruese, me një fuqi totale të instaluar në rrjetin e transmetimit prej 71.4 MW dhe në rrjetin e shpërndarjes 53.7 MW. Përqëndrimet më të mëdha të gjenerimeve janë

në zonën e Librazhdit, Prrenjasit dhe Lozhanit. Rrjeti i transmetimit është një rrjet i ndërtuar në vitet 1966-1968, me përcjellës AC-120 mm<sup>2</sup>, i cili shfaq probleme në rast stakimi të ekstremiteve të unazës 110 kV. Si rrjedhim bëhet i detyruar kufizimi i gjenerimit për të shmangur mbingarkimet dhe nivelin e lartë të tensionit. Për më tepër ka një gjenerim të madh e të përqëndruar në rrjetin 35 kV të Korçës (nënstacioni i Lozhanit) ku OSHEE është e detyruar të bëjë kufizime të gjenerimit. Për të bërë përmirësimin e situatës në këtë zonë, duke qenë se Nënstacioni 110 kV Fibër lidhet me dy linja transmetimi 110 kV me përcjellës 120 mm<sup>2</sup> nga Nënstacioni Elbasan1, si fazë e parë kërkohet ndërhyrje emergjente që përfshin:

- Ndërtimin e një linje të re 110 kV me dy qarqe Fibër-Librazhd, rreth 23 km, me përcjellës ACSR 240/40 mm<sup>2</sup>, përfshirë 2 trakte linje 110 kV në nënstacionet respektive.


Objekti parashikohet të komisionohet në fund të vitit 2020.

Në figurën më poshtë jepet skema njëfazore e rajonit Juglindor, ku paraqitet ndërhyrja që parashikohen dhe ku jepen edhe burimet e mundshme që do të lidhen në këtë rajon, të treguara gjithashtu në tabelë.

Gjeneruesi	Fuqia e instaluar (MW)	Periudha e ndertimit	Pika e Lidhjes
HEC Bushtrica 1&2	10.03	Afatshkurter	L.110 kV Librazhd - Prenjas
HEC Gostime	16.10	afatmesëm	L.110 kV Fiber – Rapun 3&4
HEC Fushbull	21.52	afatmesëm	L.110 kV Fiber - Librazhd
HEC Qarishte	37.3	afatmesëm	N/St. 110 kV Librazhd
Kaskada Shmil	16.72	afatmesëm	HEC Qarishte
HEC Hotolisht	7.77	afatmesëm	L.110 kV Librazhd - Prenjas
HEC Dragostunje	10.00	afatmesëm	HEC Hotolisht
HEC Egnatia	6.00	afatmesëm	HEC Hotolisht
HEC Sllabinja 2a,2c,2e	5.10	afatmesëm	HEC Bishnice
HEC Zona Lozhan	36.00	afatmesëm	N/St. i Ri Lozhan
HEC Lunik	7.00	Afatgjatë	HEC Rapun 3&4
HEC Bushtrica 3	6.70	Afatgjatë	HEC Bushtrica 1&2
<b>TOTAL</b>	<b>180.24</b>		



### Investimet ne Zonen Juglindore me burimet e reja gjeneruese



## **28. Punime për përfundimin e linjës kabllore 110 kV Tirana2-Selitë dhe lidhja me nënstacionin 110/20 kV Kombinat**

Linja 110 kV Tirana2-Selite përbëhet nga dy pjesë: pjesa ajrore e cila fillon në N/stacionin Tirana2 dhe përfundon pranë ish fabrikës së Qelqit në Kombinat me një gjatësi prej 6.7 km dhe pjesa kablore që kalon në zonën urbane nga ish fabrika e qelqit deri në nënstacionin e selitës me një gjatësi rreth 3 km.

Pjesa ajrore e linjës me përcjellës ACSR 240 mm<sup>2</sup>, është vënë në operim duke e shfrytëzuar provizorisht deri në përfundim të linjës kabllore një segment të linjës së vjetër Kashar – Selitë.

Punimet për pjesën kabllore të linjës janë ndërprerë nga kontraktori dhe çështja është në proces gjyqësor. Mosvënia në funksionim e pjesës kabllore sjell këto pasoja:

- Kufizim gati dy herë të kapacitetit të linjës dhe për pasojë siguri e ulët furnizimi për nënstacionin 110 kV Selitë (mosplotësim i kriterit N-1).
- Rritje të humbjeve të energjisë elektrike.
- Mbajtje në operim e pjesës së vjetër të linjës ajrore e cila kalon në një zone tashmë të mbushur me ndertime, cka përbën një rrezik për jetën e njerezve dhe vështirësi në mirëmbajtjen e saj.

Për më tepër përfundimi i linjës kabllore lidhet me plotësimin përfundimtar të skemës së rrjetit elektrike në këtë zonë, ku OSHEE ka planifikuar ndërtimin e nënstacionit 110 kV Yzberisht (Kombinat) me hyrje–dalje të linjës 110 kV Tirana2 – Selitë.

Objekti parashikohet të komisionohet përgjatë vitit 2020.

## **29. Furnizim dhe vendosje e çelave rezervë 20 kV dhe 35 kV për N/Stacionin Tirana 1 dhe pjesë këmbimi për këto çela**

Duke pasur parasysh problemet e përsëritura me çelat 20 kV në Nënstacionin Tirana1, rëndësinë e konsumatorëve që furnizohen nga këto çela (qyteti i Tiranës) dhe faktin e mungesës së pjesëve rezervë për këto pajisje, shihet i arsyeshëm propozimi që vjen nga NJOT për nevojën e kryerjes së një rehabilitimi të plotë të impiantit 20 kV në N/Stacionin 220/110/35/20 kV Tirana 1 duke marrë shkas nga faktorët si më poshtë:

- Amortizimin në vite të impiantit 20 kV (vendosur në shfrytëzim në vitin 2004);
- Rrymat e larta të lidhjes së shkurtër (Afërsia me burimin);
- Mbulimin nga bloza edhe në raste të tjera të mëparshme;
- Rrjedhje të vazhdueshme të gazit F6 në disa çelësa të impiantit;
- Lageshtinë e theksuar në kanalet e kablllove;
- Problemet mekanike me karrocet e çelësave dhe tokëzimet stacionare;



- Mungesën totale të pjesëve të kembimit dhe pajisjeve rezervë për të gjithë impjantin 20 kV;

Për një zgjidhje të shpejtë dhe emergjente, do të kryente funksion edhe shtesa prej 2 çelash 20 kV, nga një për cdo seksion dhe një celë rezervë 35 kV për të pasur një fleksibilitet në zgjidhjen e shpejtë të avarive të mundshme në impiant.

Objekti parashikohet të komisionohet brenda vitit 2019.

### **30. Ndërhyrje për rastet emergjente në linjat e transmetimit.**

Nisur nga eksperiencia shumë vjeçare në operimin e sistemit energjitik, vleresojmë që edhe pse realizohen remontet e planifikuara dhe punime jashtë rradhe, si në linjat e tensionit të lartë ashtu edhe në pajisjet e nënstacioneve, ndodh që të ballafaqohemi me situata që nuk mund të parashikohen, si rrëshqitjet masive të dheut apo kushte ekstremale të motit të cilat dëmtojnë elementë të rëndësishëm të rrjetit të transmetimit, duke sjellë kushtëzime në operimin e tij. Për të përballuar situata të tilla të cilat nuk mund të parashikohen me ekzaktësi, parashikohet një fond prej 40 milion Lekë për përballimin e situatave të emergjente.

### **31. Blerje paneleve të mbrojtjes dhe komandimit për trakte 110 kV**

Nga analizë e gjendjes në terren që specialistët e OST kanë bërë në nënstacionet 110 kV të sistemit energjitik të cilat janë në shfrytëzim dhe operohen nga personeli OSHEE, gjatë procesit të ripërcaktimit të kufirit të administrimit të rrjetit të transmetimit për transferimin e aseteve në zbatim të ligjit 43/2015, u konstatua një gjendje tejte e amortizuar e të gjitha pajisjeve primare dhe sekondare në këto nënstacione (çelsa, thika, transformatorë rryme, transformatorë tensioni, panelet e mbrojtjes, panelet e komandimit, etj).

Meqënëse procesi i transferimit të aseteve për traktet e linjave dhe pajisjet e zbarrave të nënstacioneve 110 kV tashmë (Gusht i vitit 2018) ka përfunduar, OST ka filluar ndërhyrjet për përmirësimin e situatës duke bërë ndërhyrje të rëndësishme në këto pajisje për kthimin e tyre në operim normal për aq sa është e mundur dhe normalizimin e skemës 110 kV të sistemit.

Duke konstatuar nevojën e madhe për ndërhyrje, rinovim të pajisjeve në traktet 110 kV të linjave në këto nënstacione, parashikohet që krahas procesit të rehabilitimit të nënstacioneve 110 kV që OST do të vazhdojë, paralelisht me këtë proces të vijohet edhe me ndërhyrje të pjesëshme nga specialistët e OST në trakte të veçanta aty ku është e nevojshme dhe e domosdoshme në emergjencë duke siguruar furnizimin e nevojshëm me bazën materiale, pajisjet primare-sekondare dhe duke vijuar me punimet civile ku planifikohet të përfshihen edhe njësitë operative .

Për sa më sipër, është parashikuar që të iniciohet procesi i ndërhyrjes rehabilituese me furnizimin e pajisjeve sekondare për dy trakte 110 kV (dy paneleve mbrojtje dhe komandimi për traktet 110 kV si dhe pajisjet që lidhen me to).

### **32. Blerje pajisje, materiale dhe vegla pune për mirëmbajtjen e nënstacioneve.**

Nga analiza e gjëndjes në magazinën qendrore dhe në magazinat e njësive operative për pajisjet dhe materialet për mirëmbajtjen e nënstacioneve, nisur nga kërkesat e njësive operative për këto artikuj si dhe duke pasur parasysh në mënyrë të veçantë gjëndjen teknike të nënstacioneve 110 kV e cila lidhet me shtyrjen e kufirit të Sistemit të Transmetimit dhe përfshirjen e trakteve të linjave dhe zbarave 110 kV të N/st të OSHEE mendojmë që, duhet të rritet sasia e pajisjeve dhe materialeve që duhen blerë për këtë qëllim.

Objekti parashikohet të komisionohet brenda vitit 2019.

### **33. Blerje materiale dhe vegla pune të sigurimit teknik si dhe pajisje për testimin e mjeteve të sigurimit teknik.**

Në kontrollet e ushtruara në njësitë operative në varësi të OST i është kushtuar rëndësi kontrollit të inventarit të pajisjeve mbrojtëse të sigurimit teknik dhe të punës, ku janë evidentuar mungesa në pajisje sipas sasisë së përcaktuar në Rregulloren e Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për Impjantet, Pajisjet dhe Instalimet Elektrike, shtojca Nr. 5 “Lista e inventarit të mjeteve mbrojtëse dhe të punës sipas vendit të punës”.

Një nga problemet e ngritura nga njësitë operative është testimi i Mjeteve të Sigurimit Teknik në Laborator. Koha e këtij testimi është e përcaktuar në Rregulloren e Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për Impjantet, Pajisjet dhe Instalimet Elektrike, Shtojca Nr. 6 “Normat dhe Afatet e Kontrollit të Mjeteve Mbrojtëse”, Pika A “Elektrike”.

Ky kontroll i përcaktuar në rregulloren për mirëfunksionimin dhe shmangien e incidenteve (në disa raste fatale), ka qënë në pamundësi të kryhet gjatë viteve të fundit si pasojë e mos disponimit të një laborator për testim. Për plotësimin e këtyre mangësive parashikojmë që në Programin e Zhvillimit Ekonomik për vitin 2019 të parashikohet blerja e materialeve dhe veglave të punës së Sigurimit Teknik si dhe pajisjet (laborator) për testimin e mjeteve të Sigurimit Teknik.

Objekti parashikohet të komisionohet brenda vitit 2019.

### **34. Upgrade Hardware-Software i sistemit të kontrollit të nënstacionit 220 kV Koplík si dhe releve të kontrollit në këtë nënstacion.**

Duke qënë se gjatë viteve të shkuara ka qënë një ndër sistemet që ka shfaqur problematikat më të mëdha, është e rekomandueshme të bëhet një upgrade i plotë (hardware-software) i sistemit të Nënstacionit 220/110/35/20 kV Koplík si dhe releve

të kontrollit të këtij nënstacioni (6 copë BCU). Sistemi aktual nuk jep garanci për operim normal kryesisht nga konsumimi i lartë i pajisjeve hardware që përbëjnë këtë sistem për shkak se ka mbi 10 vjet nga periudha e instalimit.

Gjithashtu në këtë sistem nuk funksionon redundanca ndërmjet dy serverave dhe komunikimi me reletë është shumë i vjetër me protokoll komunikimi LON i cili jep shkëputje të shpeshta të marrjes së të dhënave nga reletë e kontrollit drejt sistemit lokal të kontroll-monitorimit. Kjo çon në mungesë informacioni për operatorin lokal gjithashtu edhe në mungesë informacioni për Dispeçerin Qëndror.

Serverat e sistemit janë gjithashtu shumë të ngarkuar me procese pune dhe rendimenti i tyre është zvogëluar ndjeshëm duke çuar në vonesa të shfaqjes së të dhënave në monitorët e operimit apo në kryerjen me vonesë të procesit të komandimit lokal nga nënstacioni apo të komandimit në distancë nga Dispeçeria Qëndrore.

Nënstacioni i Koplikut është i rëndësishëm pasi ka dhe një linjë interkonjeksioni me Malin e Zi dhe vlera e shkëmbimit të energjisë nga kjo linjë është e domosdoshme për vendosjen në punë të LFC-së në sistemin SCADA/EMS. Shkëputjet e shpeshta të komunikimit të sistemit lokal me sistemin qëndror pengojnë operimin normal të LFC-së prandaj konsiderohet shumë e rëndësishme upgrade-i i këtij sistemi.

Objekti parashikohet të komisionohet brenda vitit 2019.

### **35. Upgrade Hardware-Software i sistemit të kontrollit të nënstacionit 400/220/110kV Tirana 2**

Duke marrë shkas nga problematikat e shfaqura gjatë viteve të kaluara në sistemin e kontrollit të nënstacionit 400 kV Tirana 2 është e domosdoshme të bëhet një Upgrade i plotë (hardware-software) i sistemit në këtë nënstacion. Sistemi aktual ka kaluar një periudhë 10 vjeçare të përdorimit dhe sipas standardeve të aplikuara në nënstacionet elektrike rekomandohet Upgrade-imi ose zëvendësimi i tyre pas një periudhe 10 vjeçare.

Sistemi aktual është në versione shumë të vjetra të Windows-it, përkatësisht Windows XP SP2 (version i vitit 2001). Për këto sisteme Windows kompania Microsoft ka mbyllur çdo lloj update dhe supporti duke bërë që sistemet e këtij versioni të mos jenë më të përditësuara me patch-et e fundit, gjë e cila ul ndjeshëm sigurinë e sistemeve. Aktualisht nuk prodhohen më pjesë zëvendësuese për pajisjet integrale të këtyre sistemeve të Kontroll-Monitorimit sic janë (Serverat, Workstation, Karta LON për server, Karta Profibus për server). Nuk prodhohen më as versione të softeve të instaluar në server, gjë që bën shumë të vështirë mirëmbajtjen e tyre. Liçensat e blera nga OST për këto nënstacione janë drejt përfundimit dhe është tejet i vështirë shtimi i elementeve të rinj në skemat e këtyre nënstacioneve.

Serverat e sistemeve janë shumë të ngarkuar me procese pune dhe rendimenti i tyre është zvogëluar ndjeshëm duke çuar në vonesa të shfaqjes së të dhënave në monitorët

e operimit apo në kryerjen me vonesë të proceseve të komandimit lokal nga nënstacioni apo të komandimit në distancë nga Dispeceria Qendrore.

Përkatësisht në n/st 400 kV Tirana 2 ka ndodhur disa herë bllokimi i të dhënave të linjës së Interkonjeksionit Tirana 2-Podgorica, të dhëna që nisen drejt SCADA/EMS duke bërë që të ketë devijime të paqëllimshme në modulën AGC duke rezultuar në mospërmbushje të detyrimit për mbajtjen e balancës për zonën e kontrollit por dhe kosto shtesë për Shoqërinë në raport me manaxhimin e portofolit të disbalancave. Procesi i Upgrade-imit redukton në zero mundësinë e gabimeve të tilla si dhe ul ekspozimin drejt rreziqeve operationale nga keq funksionimi i sistemeve të automatizuara për kontrollin/mbajtjen e balancës në zonën e kontrollit.

Gjithashtu vlen për t'u përmendur vënia në eficensë të plotë të projekteve komplementare duke konsideruar dhe projektet në nënstacionin Tirana 2 parashikuar për tu realizuar me financim të siguruara nga fonde të huaja për shtimin e trakteve të reja 220 kV Tirana 2- Rrashbull, atë të traktit 110 kV Tirana 2-Traktora dhe traktit 110kV Tirana 2- nënstacioni Kombinat (investim i OSHEE sh.a.). Të gjitha këto integritime lehtësohen me sisteme kontrolli moderne me të gjitha avantazhet që ofron teknologjia e fundit në këtë fushë.

Së fundmi duke qene se rajoni i Tiranës është më i rëndësishmi në rang vendi për sa i përket zonës së veprimt, ndërthurjes me rrjetin e OSHEE sh.a., veprimeve operative si dhe saktësisë së lartë në operim dhe ne nje kohe te shkurter që kerkohet, gjykohet domosdoshmeria e upgrade-imit të këtij sistemi kontroll-monitorimi.

Objekti parashikohet të komisionohet brenda vitit 2019.

### **36. Blerje e Programit kompjuterik për analizën e rrjetit**

Një ndër objektivat kryesor të Sektorit të Planifikimit të Operacioneve, është analiza statike dhe dinamike e rrjetit të sistemit të transmetimit. Për këtë kërkohet një soft llogaritës i cili duhet të kryejë analizat e mëposhtme:

- Analize statike të rrjetit, ku përfshihet, modelimi bazë i rrjetit të transmetimit dhe shpërndarja e flukseve në këtë rrjet. Llogaritje e shpërndarjes së flukseve dhe krijimi i raporteve me rezultate. Modifikimi i të dhënave të modeleve dhe topologjive ekzistuese. Identifikimi automatik i problemeve gjatë modelimit të elementeve të rrjetit. Menaxhimi i të dhënave të shpërndarjes së flukseve. Kryerja e analizës së lidhjeve të shkurtra. Procesi i shkycjeve të balancuara, lëshimi i motorëve, llogaritjet e nivelit të tensionit dhe afishimi i rezultateve. Procesimi i kontigjencave dhe llogaritjet e kapacitetit transmetues midis zonave. Aplikacione të tjera që përfshijnë analizat PV/QV.

- Analizë dinamike të rrjetit, ku përshihet mundësia për modelimin e elementeve të sistemit elektroenergjetik me modele dinamike (lineare dhe jo lineare) në varësi të sjelljes së çdo elementi. Modelimi i rregullatorëve të shpejtësisë, sistemeve të eksitimit, modelimi i ngarkesës, modelimi i gjeneratoreve, modelimi i transformatorëve etj. Softi gjithashtu duhet të jetë në gjendje të lejojë automatizim të proceseve, duke zhvilluar analizë dinamike të sistemit elektroenergjetik, në rrafshë kohore të ndryshme, duke realizuar afishimin e rezultateve të analizës dinamike në formë grafike.

Të suportojë formatet UCT, CIM/CGMES, RAW dhe konvertimet midis këtyre formateve.

Objekti parashikohet të komisionohet brenda vitit 2019.

### **37. Blerjen e dy liçensave USB për program kompjuterik PSS©E për analizën e rrjetit**

Aktualisht OST ka në përdorim dy liçenca që shfrytëzohen përkatësisht nga dy drejtori, një çelës nga DPZHARRT dhe një çelës nga DOS.

Duke qënë se aktiviteti i përdorimit të këtij programi është rritur, shpesh bëhet e papërbalueshme puna vetëm më një çelës.

Blerja e dy liçensave të reja (çelsa USB) të Programit PSS/E, është i domosdoshëm për ploësimin e nevojave të sektorëve të planifikimit afat gjatë dhe afat mesëm për zhvillimin e Rrjetit, si dhe nevojat e planifikimit afat shkurtër për menaxhimin e konxhestioneve, kriterin e sigurisë N-1 dhe analizën e punës së SE.

Me anë të këtij programi realizohen:

- Analiza të shpërndarjes së flukseve të fuqisë
- Menaxhimi i të dhënave për shpërndarjen e flukseve
- Analiza e kufuzimeve të kapaciteteve
- Analiza e limiteve në transmetim
- Analiza e lidhjeve të shkurtra
- Analiza PV/QV
- Krijimi i Rrjetave Ekuivalente
- Simulime dinamike
- Manipulimin e rezultateve të simulimeve dinamike, edhe grafikisht
- Paraqitjen grafike të rrjetit (Harta apo diagrama)

Ky program është bazë për hartimin e modeleve nacionale të rrjetit të transmetimit, që janë bazë për të gjitha analizat e rrjetit.

Përveç kësaj janë bazë për përdorimin e tyre në hartimin e modeleve rajonale, që OST ka obligimin dhe jep kontributin e saj si anëtare e ENTSO/E tashmë.

Objekti parashikohet të komisionohet brenda vitit 2019.

### 38. Mbikqyrja e punimeve gjatë zbatimit të kontratave.

OST ka parashikuar në Programin e Zhvillimit Ekonomik të vitit 2019 disa projekte që në bazë të VKM-së Nr. 914, datë “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe Udhëzimit Nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, të Këshillit të Ministrave, të parashikojë si shtesë në regjistrin e investimeve vlerën e kontratave të mbikqyrjes së punimeve.

### B. Tabela me Planin e Investimeve të Huazuara për vitin 2019

Nr	Pershkrimi I Projektit	Vlera e fondeve të angazhuara	Parashikim 2019						
			Per tu disbursuar nga Kredia			Per tu Financuar nga OST Sh.a		Grant	
			Valute(Euro)	Valute(Euro)	ne mln Leke	Valute (Euro)	ne mln Leke	Valute(Euro)	ne mln Leke
1	Zgjerimi i sistemit të matjes për konsumatorët e kualifikuar*	18,687,500	1,545,975	207	386,494	52		-	
2	1)L 220 kV Tirane - Rrashull , 2)Fuqizimi I Rrjetit Unazor 110 kV të qytetit të Tiranës(kablor) dhe ndërtimi I N/Stacionit 220/110 kV(opsion 400/110 kV ) Tirana 3 - Konsulenca Fichtner	40,000,000	10,000,000	1,338		-		-	
3	1)Ndërtimi I Linjes së Interkoneksionit 400 kV Elbasan-Bitola (Maqedoni); 2)N/Stacioni I Ri 400kV Elbasan 3; 3)Linja Elbasan Fier dhe 4) Nenstacioni Fier	64,851,000	9,360,000	1,253		-	3,196,000	428	
4	Kosto lokale	-	-	-		50		-	
5	Investimet me fondet e veta	-	-	-		2,341		-	
6	<b>Totali</b>	<b>174,957,037</b>	<b>20,905,975</b>	<b>2,798</b>	<b>386,494</b>	<b>2,439</b>	<b>3,196,000</b>	<b>428</b>	

Më poshtë gjeni relacionet përkatëse për secilin nga zërat në listën e Planit të Investimeve me Fondet e Huazuara të vitit 2019:

#### 1. Projekti për instalimin e Matjes në Konsumatorët TM dhe Qendra e Menaxhimit të informacionit.

Projekti është komponenti i tretë i programit “Rimëkëmbja e Energjisë” të financuar nga Banka Botërore.

Ky projekt përfshin vendosjen e një sistemi të ri të matjes On Line në konsumatorët e Tensionit të mesëm dhe Fidrat e Tensionit të mesëm si dhe ngritjen e qendrës së Menaxhimit të të dhënave pranë OST-së. Realizimi i këtij projekti do të krijojë kushtet e nevojshme për të realizuar daljen e ketyre konsumatorëve në tregun e hapur të energjisë elektrike. Sistemi i matjes do të përfshijë të gjithë fiderat dalës të tensionit të mesëm 20 kV, 10 kV dhe 6 kV nga N/stacionet e OSHEE-së, rreth 1200 pika matje, rreth 300 IPP dhe do të vazhdojë me klientët më të mëdhenj të lidhur në rrjetin e

tensionit të mesëm, rreth 1500. Sistemi do të jetë i aftë të përpunojë të dhënat për 10,000 klientë, që do të operojnë në tregun e lire të energjisë elektrike. Proçedura e prokurimit për këtë nënkomponent është e përfunduar dhe Miratimi i Bankës Botërore si financues i këtij projekti është marrë në datë 23 Mars 2017. Kontrata është nënshkruar në 21 Prill 2017 dhe ka një kohëzgjatje prej 32 Muaj. Hapja e tregut të energjisë elektrike është një nga objektivat kryesorë të Qeverisë Shqiptare dhe si e tillë është një prioritet për OST.

Situata e parashikimit të disbursimeve për vitin 2019 jepet në tabelën e mëposhtme.


Pershkrimi i Projektit	Parashikim 2019							
	Per tu disbursuar nga Kredia				Per tu financuar nga OST sh.a			
	6- mujori I		6- mujori II		6- mujori I		6- mujori II	
	Valute (Euro)	Leke	Valute (Euro)	Leke	Valute (Euro)	Leke	Valute (Euro)	Leke
Zgjerimi i sistemit te matjes per konsumatoret e kualifikuar	927,585.02	124,138,703.76	618,390.02	82,759,135.84	231,896.26	31,034,675.94	154,597.50	20,689,783.96

## 2. Projekti Eficenca e Energjisë


Ky projekt përfshin ndërtimin e Linjës 220 kV me dy qarqe Tirana2- Rrashbull dhe fuqizimi i N/st. 220/110 kV Rrashbull dhe Unaza 110 kV e Tiranës.

Projekti është financuar nga një kredi e Qeverisë Gjermane, nëpërmjet Bankës KfW me një kredi me 40 mln Euro. Ky projekt do të bëjë të mundur rritjen e besueshmerisë së funksionimit të rrjetit 220 kV të rajonit të Durrësit dhe të Jugut të Shqipërisë duke plotësuar kriteret teknike të sigurisë dhe cilesisë. Gjithashtu ky projekt do të përmirësojë kushtet aktuale të furnizimit me energji elektrike të qytetit të Tiranës, duke konsideruar që një pjesë e rëndësishme e rrjetit unazor 110 kV që furnizon me energji elektrike nënstationet e sistemit të kësaj zone është ndërtuar mbi 40 vjet më herët dhe përbëhet nga linja ajrore të amortizuara dhe kapacite transmetimi të limituara.

Projekti është ende në fazën e tenderimit (sapo janë paraqitur nga ofertuesit dokumentacioni për fazën teknike) për perzgjedhjen e kontraktorëve që do të realizojnë kontratën e zbatimit të projektit, përkatësisht sipas loteve: Loti 1 – N/Stacionet dhe Loti 2- Linjat.



Linja 220 kV me dy qarqe Tirana2- Rrashbull dhe fuqizimi i N/st. 220/110 kV Rrashbull pjesë e Projektit Efienca e Energjisë.



Skema njëfazore e realizimit të projektit të Unazës së Tiranës pjesë e Projektit Efienca e Energjisë.

Situata e parashikimit të disbursimeve për vitin 2019 jepet në tabelën e mëposhtme.

Pershkrimi i Projektit	Parashikim 2019			
	Per tu disbursuar nga Kredia			
	6- mujori I		6- mujori II	
	Valute (Euro)	Leke	Valute (Euro)	Leke
Efienca e Energjise - ndertimi i linjes se transmetimit me dy qarqe 220 kV Tirane - Rrashbull dhe Unaza 100 kV e Tiranës	5,000,000.00	669,150,000.00	5,000,000.00	669,150,000.00



### 3. Ndërtimi i linjës së interkonjeksionit 400 kV Elbasan2 (Shqipëri) – Bitola (Maqedoni) dhe Elbasan2 – Fier si dhe si dhe zgjerimi i nënstacioneve Elbasan2 dhe Fier

Projekti është financuar nga një kredi e Qeverisë Gjermane, nëpërmjet Bankës KfW. Ky projekt përforcon lidhjet interkonektive me rrjetin rajonal të energjisë elektrike, duke krijuar kushte për shkëmbime tregtare dhe tranzitime pa kufizim të energjisë elektrike në rajon, zhvillon rrjetin 400 kV në zonën Jugore të Shqipërisë ku parashikohen të zhvillohen burimet e ardhshme të prodhimit të energjisë elektrike, dhe si pjesë e infrastrukturës së Korridorit të Tetë Evropian krijon mundësi të mira për lidhje nëpërmjet kabllit nënujor me Italinë.

Financimi i projektit të transmetimit të energjisë elektrike, i cili përbëhet nga dy pjesë: (i) Elbasan - Qafë-Thanë dhe (ii) Elbasan-Fier, do të sigurohet nga Bashkëpunimi Gjerman Shqiptar i Zhvillimit.

Qeveria Gjermane, tashmë ka angazhuar fonde për një kredi të zhvillimit deri në 50 milion euro për Qeverinë e Shqipërisë.

Përveç kësaj, për të mbuluar financimin e plotë të projektit do të vihen në dispozicion edhe një grant investimi nga WBIF deri në 14 milion euro.

Gjithashtu, rreth 1.2 milion euro, do të angazhohen nga WBIF dhe Bashkëpunimi për Zhvillim Gjermano Shqiptar, fonde të cilat do të përdoren për përgatitjen e dizajnit kryesor.

Se fundmi, OST sh.a, është angazhuar të mbulojë gjatë implementimit të projektit dhe kostot lokale, të cilat janë përlogaritur të jenë rreth 5 milion Euro.



*Gjurma e linjës 400 kV të interkoneksionit Elbasan2 – Manastir*




Diagrama njëfazore, linja 400 kV Elbasan – Fier

Projekti është ende në fazën e tenderimit, për përzgjedhjen e kompanisë konsulente, aktualisht është faza e vleresimit të propozimeve teknike. Situata e parashikimit të disbursimeve për vitin 2019 jepet në tabelën e mëposhtme.

Pershkrimi i Projektit	Parashikim 2019							
	Per tu disbursuar nga Kredia				Grant			
	6- mujori I		6- mujori II		6- mujori I		6- mujori II	
Valute (Euro)	Leke	Valute (Euro)	Leke	Valute (Euro)	Leke	Valute (Euro)	Leke	
Linja 400 kV 400 kV Elbasan-Bitola (Maqedoni); 2)N/Stacioni I Ri 400kV Elbasan 3; 3)Linja Elbasan Fier dhe 4) Nenstacioni Fier	-	-	9,360,000.00	1,252,648,800.00	1,278,400.00	171,088,272.00	1,917,600.00	256,632,408.00

#### 4. Projekti për realizmin e një studimi Master Plan të zhvillimit të Sistemit të Transmetimit

Projekti është financuar nga nje Grant të Qeverise Gjermane, nepermjet Bankes KfW. Ky projekt synon qe të realizojë përgatitjen e një Master Plani Zhvillimi të Sistemit të transmetimit të energjisë elektrike në Shqipëri.

Ky projekt synon qe të realizojë përgatitjen e një Master Plani Zhvillimi të Sistemit të transmetimit të energjisë elektrike në Shqipëri. Realizimi i ketij Master Plani do të shërbejë për të krijuar nje zhvillim sa me të koordinuar dhe harmonik ndërmjet realizimit të investimeve më prioritare në sistemin e transmetimit. Më këtë Master-Plan, synohet të vlerësohet dhe të shqyrtohet gjendja e sistemit ekzistues të transmetimit dhe të identifikohen kufizimet aktuale të Sistemit të Transmetimit në Shqipëri dhe ato që mund të lindin në të ardhmen.

Është përzgjedhur kompania konsulente për këtë projekt dhe është zhvilluar kick-off meeting.

Situata e parashikimit për zërin kosto lokale “financim nga OST sh.a lidhur projekteve me financim të huaj” për vitin 2019, jepet e përmbledhur për të gjithë projektet, në tabelën e mëposhtme.

Kosto Lokale	Parashikim 2019	
	Per tu disbursuar nga Kredia	
	6- mujori I	6- mujori II
	Leke	Leke
Kosto Lokale - (Tatime, tarifa, detyrime doganore)	25,000,000.00	25,000,000.00

### C. Plani 10-Vjeçar 2015-2025 i zhvillimit të transmetimit

	Objektet	Tipi i përcjellësit (mm <sup>2</sup> )	Gjatësia (km)	Fuqia (MVA)	Viti i komisionimit	Vlera (Euro)
1	Linja 110 kV Uznovë-Çorovodë dhe dalje 110 kV Uznovë	ACSR 240/40	33	122	2015	3,320,000
2	Linja 110 kV Lapaj-Peshkopi dhe dy dalje 110 kV	ACSR 240/40	32	122	2015	3,500,000
3	Blerja e dy AT 220/110/10 kV Burrel	2 x 60 MVA	-	120	2015	1,600,000
4	Blerja e një AT 220/110/10 kV Elbasan	1 x 120 MVA	-	120	2015	1,200,000
	Blerja e një AT 220/110/10 kV Elbasan	1 x 120 MVA	-	120	2017	1,200,000
5	Linja 110 kV me dy qarqe Burrel-Bulqizë dhe dy dalje linje 110 kV	2xACSR 240/40	30	122	2021	4,000,000
6	Linjë e re 110 kV, Rrashbull-Golem-Kavajë	2xACSR 240/40	18	-	2016	1,700,000
7	Linja me dy qarqe Ulëz-Shkopet-Skuraj	2xACSR 240/40	10.5	-	2016	1,800,000
8	Linja me një qark Skuraj-Laç1	ACSR 240/40	12.7	-		
9	Linja me një qark Skuraj-Laç2	ACSR 240/40	10.1	-	2018	1,800,000
10	Linja me dy qarqe Laç2-Laç1	2xACSR 240/40	2.7	-		
11	Përforcim linje 110 kV, Lezhë-Laç2	ACSR 240/40	19.5	-	2021	1,700,000
12	Përforcim linje 110 kV, Ulëz-Kurbnesh	ACSR 240/40	23	-	2023	2,000,000
13	Linjë e re 110 kV, Lapaj-Lurë, dy dalje linje 110 kV	ACSR 240/40	19	-	2023	1,600,000
14	Linjë e re 110 kV, Sukth-Gj.Lalzit, dy dalje linje 110 kV	ACSR 240/40	18	-	2019	1,900,000
15	Linjë e re 110 kV, Bulqizë-Tërnovë-Gjoricë	ACSR 240/40	20	-	2021	1,900,000
16	220/110 kV Fierzë, 1 dalje TR 220 kV, 1 dalje TR 110 kV	-	-	2x60	2018	2,000,000
17	Linjë e re 110 kV, Kukës-Prizren, 1 dalje linje 110 kV (N/St Kukës)	ACSR 240/40	13	-	2022	1,500,000
18	Përforcim linje 110 kV, Elbasan1-Fibër, Fibër-Librashid	2xACSR 240/40	30	-	2019	3,000,000
19	Përforcim linje 110 kV, Elbasan1-GSA-Cërrik-Kajan	ACSR 240/40	24	-	2021	2,040,000
20	Përforcim linje 110 kV, Kajan-Kuçovë-Marinëz-Fier	ACSR 240/40	59	-	2023	5,015,000
21	Linjë e re 110 kV, Fier-Lushnjë	ACSR 240/40	30	-	2025	2,400,000
22	Plotësim i qarkut të dytë të linjës 220 kV Fier-Babicë-TEC Vlorë	ACSR 490/65	35	-	2024	1,000,000
23	Linjë e re 110 kV, Ballsh-Memaliaj-Dragnet, N/St.Dragot 220/110	ACSR 240/40	48	-	2025	7,080,000
24	Plotësim i qarkut të dytë të linjës 110 kV Kuçovë-Uznovë-Çorovodë	ACSR 240/40	58	-	2025	1,000,000
25	Linjë e re 110 kV, Tirana1-Qëndër(kabllore), një dalje linje 110 kV	XLPE-AL1000	2.3	-	2022	1,500,000
26	Linjë e re 110 kV, Koplik-Shkodra1	ACSR 240/40	20	-	2025	1,700,000
27	Linjë e re 110 kV, Kosmaç-Velipojë	ACSR 240/40	28	-	2020	2,380,000
	<b>TOTALI</b>					<b>285,437,528</b>

OST ka hartuar Planin afatgjatë 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit të Sistemit të Transmetimit për horizontin 2015-2025 dhe e ka miratuar atë në ERE me Vendim Nr. 212, datë 28.12.2017. Ky plan 10-vjeçar i zhvillimit është koordinuar edhe me Planin 10-vjeçar të Rrjetit ENTSO-E (TYNDP), duke zbatuar kriteret dhe metodologjitë e tij për planifikimin afatgjatë të rrjetit të sistemit të transmetimit.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” në Qershor të vitit 2015, kufiri i pronësisë së sistemit të transmetimit ka ndryshuar në:

*“Operatori i Sistemit të Transmetimit ka në pronësi sistemin e transmetimit të energjisë elektrike, që përfshin linjat 400 kV, 220 kV dhe 110 kV, nënstationet e transformimit të energjisë elektrike me nivele të transformimit të tensionit të lartë 400 kV, 220 kV dhe zbarat 110 kV në të gjitha nënstationet 110/TM kV, deri në pikën e matjes së energjisë në anën 110 kV të transformatorëve 110/TM kV, përfshirë pajisjet kyçëse/shkyçëse të linjave 110 kV.”*

Plani 10-vjeçar i zhvillimit të rrjetit është përgatitur para vitit 2015 dhe për rrjedhojë ky ndryshim nuk ka qënë i përfshirë. Duke marrë në konsideratë që një pjesë e madhe e këtyre pajisjeve janë tepër të amortizuara dhe një pjesë tjetër mungojnë (skemat e operimit nuk janë në kushte optimale për sigurinë e furnizimit dhe nuk plotësojnë kriterin e sigurisë statike), një pjesë e investimeve vjetore janë fokusuar në këto elementë të rrjetit të cilat u bënë pjesë e sistemit të transmetimit pas hyrjes në fuqi të ligjit. Në këto kushte, në pamundësi për të ndërhyrë me fondet e brëndshme në projektet e evidentuar, është kërkuar në ERE miratimi i kërkesës për ndërhyrje në rrjetin e transmetimit nëpërmjet fondeve të huazuara. Në këto projekte ishin përfshirë edhe disa zëra të Planit 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit 2015-2025.

Për sa më sipër, në kushtet e ligjit dhe akteve rregullatore të tij, propozojmë për miratim përditësimin e Planit 10-vjeçar 2015-2025 të zhvillimit të rrjetit me të njëjtën përmbajtje por në ndryshim termat kohor të realizimit të projekteve (komisionimin e tyre) sipas listës së mësipërme.

Me respekt,

**ADMINISTRATORI I OST sh.a.**



**Skerdi Drenova**



OST  
OPERATORI  
I SISTEMIT TE  
TRANSMETIMIT